




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr.524/2023**

**Datë: 27 nëntor 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë, në takimin 317-të, të mbajtur me datë 27 nëntor 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet kërkesa e Xhelal Bajrami, gjyqtar porot në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për transferim në Gjykatën Themelore në Ferizaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

**A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga Xhelal Bajrami, gjyqtar porot në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kërkesën për transferim në Gjykatën Themelore në Ferizaj. I njëjti kërkesën e tij e ka arsyetuar me faktin e afërsisë që ka nga vendbanimi me Gjykatën Themelore Ferizaj.

Pas vlerësimit të kërkesës së z. Bajrami, KGJK-ja vendosi ta refuzoj të njëjtën sepse me asnjë dispozitë të legjislacionit në fuqi, nuk parashihet transferimi i gjyqtarëve porotë si dhe po ashtu mënyra e caktimit të tyre bëhet sipas renditjes së përcaktuar me vendim të Këshillit dhe e njëjta vlen për secilën gjykatë, gjithashtu përkundër që konkursi ka qenë i hapur edhe për Gjykatën Themelore në Ferizaj, i njëjti nuk ka aplikuar.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Vendimi i dërgohet:

- Gjyqtarit porot Xhelal Bajrami;
- Sekretariatit të KGJK-së,
- Arkivit të SKGJK-së.